

AKT NORMATIV
Nr. 3, datë 18.1.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË NËNSHKRUAR “PËR PRODHIMIN
DHE FURNIZIMIN NDËRMJET PFIZER EXPORT B.V. DHE MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHETIT PËR
RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 101, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Neni 1
Miratimi i marrëveshjes

Miratimin e marrëveshjes së nënshkruar “Për prodhimin dhe furnizimin ndërmjet Pfizer Export B.V., Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij akti normativ.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama